FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 86

Tiranë – E premte, 14 qershor 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 13.6.2019	Mbi aktin e Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit nr. 10 928, datë 5.11.2018 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore".....	6283
Dekret i Presidentit nr. 11200, datë 10.6.2019	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	6284
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 381, datë 12.6.2019	Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huaja.....	6285
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 382, datë 12.6.2019	Për emërimin në detyrë të një anëtari të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.....	6289
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 383, datë 12.6.2019	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, për kompensimin e veçantë të familjeve të ushtarakëve të rënë në krye të detyrës, gjatë përmbushjes së misionit ushtarak, jashtë vendit.....	6290
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 12.6.2019	Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore.....	6290
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 387, datë 12.6.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 216, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019".....	6301

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 388, datë 12.6.2019	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me numër 274/18, zona kadastrale 3115, Bashkia Përmet.....	6301
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.6.2019	Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit.....	6304
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 22, datë 24.4.2019	Për përcaktimin e kategorisë së klientit për rezidencat studentore publike.....	6306
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 5883/1, datë 12.6.2019	Për shpronësim, për interes publik të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti: "Rikonstruksioni i kompleksit të shkollave dhe terreneve sportive Fier Shegan" Lushnjë.....	6308
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 5884/1, datë 12.6.2019	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Rikualifikim i breg liqenit me struktura publike rekreative, zadra/mol panoramik dhe shtigje këmbësore natyrore".....	6309

REZOLUTË

MBI AKTIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHFUQIZIMIN E DEKRETIT NR. 10 928, DATË 5.11.2018 "PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE"

Kuvendi i Shqipërisë:

-Duke i kushtuar rëndësinë maksimale momentit historik në të cilin ndodhet vendi për procesin integrues me Bashkimin Europian, në pritje të vendimit të Këshillit Europian pas rekomandimit pa kushte të shprehur në progres-raportin e Komisionit Europian të datës 29 maj 2019 për çeljen e negociatave të anëtarësimit me BE-në;

-Duke ripërsëritur vendosmërinë dhe vullnetin e plotë për një reformë zgjedhore gjithëpërfshirëse, të pranuar gjerësisht nga aktorët politikë në vend, në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODHIR-it, pasqyruar në raportet e monitorimit për zgjedhjet e mëparshme, si dhe në harmoni të plotë me standardet ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe të barabarta;

- Duke mbështetur fuqimisht zbatimin e reformës në drejtësi, si kriter kyç për të ardhmen Europiane të vendit, si dhe për sundimin e ligjit dhe forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, reformë që vlerësohet me nota shumë pozitive në progres-raportin e Komisionit Europian dhe ku Shqipëria veçohet si shembull për t'u ndjekur nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor;

- Duke vlerësuar ngritjen e organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, si Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, hapat e ndërmarra për plotësimin e shpejtë të vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese, për ngritjen e Prokurorisë dhe Gjykatës Speciale Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm dhe duke inkurajuar intensifikimin e zbatimit të reformës në drejtësi në këtë drejtim;

- Duke vlerësuar të drejtën kushtetuese të qytetarëve për të protestuar lirisht dhe në formë paqësore, por duke dënuar çdo formë dhune kundër jetës, pronës, rendit institucional dhe organeve të shtetit, të cilat, në të njëjtën kohë, ndikojnë negativisht në imazhin e vendit, minojnë procesin e reformave dhe procesin e hapjes së negociatave për anëtarësim në Bashkimin Europian;

- Duke vlerësuar dialogun politik dhe institucional midis aktorëve politikë, parlamentar dhe joparlamentar, si rrugën e vetme që njeh demokracia funksionale për bashkëjetesën politike dhe shoqërore, ashtu si dhe rekomandon Komisioni Europian në raportin e majit 2019, se partitë e opozitës jashtëparlamentare duhet të ripërfshihen në mënyrë konstruktive në institucione demokratike e të ndalin veprime që bien ndesh me parimet demokratike;

- Duke mbajtur përgjegjësinë që i ngarkon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 1 të saj, ku shprehimisht thuhet se Shqipëria është republikë parlamentare;

- Duke respektuar parashikimin kushtetues se qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike;

- Duke mbajtur në konsideratë rolin e Presidentit në një republikë parlamentare si një organ neutral, i paanshëm dhe i pavarur, si një organ që qëndron në të gjitha pushtetet dhe që nuk bën pjesë në to, si një institucion që nuk mund të jetë aktiv në proceset vendimmarrëse politike, me qëllim shmangien e qëndrimeve politiko - partiake në ushtrimin e funksioneve të tij shtetërore;

Kuvendi i Shqipërisë, pasi u njoh me aktin e Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit nr. 10 928, datë 5.11.2018, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore" dhe duke konsideruar se ky është një akt i paprecedent që synon të mohojë realizimin e së drejtës kushtetuese të shtetasve shqiptarë për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në pushtetin vendor, konstaton:

- Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor nuk i njohin Presidentit të drejtën për të anuluar zgjedhjet;

- Akti i Presidentit, në mënyrë të kundërligjshme, ka për qëllim ndërhyrjen në një proces zgjedhor tashmë të shpallur dhe të administruar sipas kritereve, kushteve dhe afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor, ashtu si është procesi i nisur për organizimin dhe

administrimin e zgjedhjeve të datë 30 qershor 2019;

- Ky akt tenton të ndërhyjë drejtpërdrejt në një proces që tashmë është në kompetencë të organit administrues të tij dhe si i tillë duhet shqyrtuar dhe vlerësuar nga organet e administrimit zgjedhor të parashikuara në Kodin Zgjedhor;

- Është detyrim i administratës zgjedhore, jo vetëm të garantojë ushtrimin e së drejtës së zgjedhjes sipas standardeve kushtetuese dhe ligjore nga shtetasit shqiptarë, por edhe ta mbrojë ushtrimin e kësaj të drejte nga çdo ndërhyrje e paligjshme, e kryer ose që tentohet të kryhet, nga çdo person fizik apo juridik, duke mos lejuar cenimin e mbarëvajtjes së këtij procesi;

- Sipas parimit të ligjshmërisë dhe përgjegjësisë, si dhe diskrecionit të organeve administrative, sipas të cilave asnjë organ nuk ka detyrimin dhe nuk mban përgjegjësi ligjore nëse nuk zbaton një urdhër, akt apo çfarëdo vendimi absolutisht të pavlefshëm dhe që bie në kundërshtim flagrant me Kushtetutën dhe ligjin;

- Ndërhyrjen e Presidentit të Republikës në këtë fazë të procesit zgjedhor si një mjet që ka cenuar rëndë barazinë e konkurrimit politik, duke shkelur kështu paanësinë politike që Kushtetuta i ka veshur Presidentit të Republikës;

- Mundësinë e aktivizimit të mekanizmave të kontrollit dhe hetimit parlamentar parashikuar nga neni 90, paragrafi 2, i Kushtetutës;

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson se akti i Presidentit datë 10.6.2019 për shfuqizimin e dekretit nr. 10 928, datë 5.11.2018, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", është një akt absolutisht i pavlefshëm, i nxjerrë në kapërcim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të institucionit të Presidentit dhe si i tillë ai konsiderohet nul dhe sikur nuk ka ekzistuar asnjëherë.

Kuvendi i Shqipërisë mbështet qëndrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vijimin e procesit zgjedhor dhe inkurajon këtë organ të vijojë të mbrojë pacenueshmërinë, si dhe të garantojë vazhdimësinë e procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019, në zbatim të dekretit të Presidentit nr. 10 928, datë 5.11.2018 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", duke e njohur këtë të fundit si të vetmin akt të ligjshëm të nxjerrë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë në kuadër të zgjedhjeve vendore 2019.

Kuvendi i Shqipërisë u bën thirrje të gjitha organeve publike, që ngarkohen nga ligji me detyra, në kuadër të mbarëvajtjes dhe organizimit të zgjedhjeve vendore të qershorit 2019, të konsiderojnë si inekzistent aktin e Presidentit, datë 10.6.2019, për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 5.11.2018, dhe të vijojnë përmbushjen e detyrave të tyre sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës për të garantuar të drejtën kushtetuese të shtetasve shqiptarë për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në pushtetin vendor.

Kuvendi i Shqipërisë i bën thirrje Presidentit të Republikës të reflektojë duke kthyer institucionin e Presidentit në kufijtë e kompetencave të njohura nga Kushtetuta dhe të mos ndërmarrë asnjë veprim tjetër në shkelje flagrante të Kushtetutës.

Miratuar në datën 13.6.2019

KRYETAR
Gramoz Ruçi

DEKRET
Nr. 11200, datë 10.6.2019

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Veselinka (Drita) Janko Krstović (Matoja)
2. Astrit Sefer Rehse (Tare)
3. Liljana Shefqet Kurti (Lika/Likaj)
4. Ilir Dali Kurti
5. Aleksandra Dhimitër Vanikakis (Zhongo)
6. Lulzim Sali Masha

7. Valbona Tasim Felsch (Halimi)
8. Anduela Uzri Halili
9. Fiora Arjan Rusi
10. Anila Avni Nela
11. Cindy Arben Bakllava
12. Fabian Qemal Lakasi
13. Aleks Nijazi Lajthia
14. Sidorela Enver Lajthia (Shahini)
15. Sabina Aleks Lajthia
16.Axel Aleks Lajthia
17. Evangjellos (Vangjel) Stavro Kapsalidhi
18. Alfons Fran Prelaj
19. Esmeralda Miftar Hyska (Ramadani)
20. Ambra Ervis Hyska
21. Juneid Ervis Hyska
22. Ervin Sadi Aga
23. Eric Kastriot Çelanji
24. Mirjana Bozho Krstoviq (Alkaj/Krstović/Krstovic)
25. Malvina Shkëlqim Kallulli
26. Duena Elvis Hebovija

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 381, datë 12.6.2019

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN, KONTRAKTIMIN E PAGESËN E AVOKATËVE OSE ZYRAVE TË AVOKATISË VENDASE OSE TË HUAJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, dhe të shkronjës "c", të nenit 7, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i procedurave dhe i kritereve për përzgjedhjen, kontraktimin dhe pagesën e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huaja.

2. Procedura për kontraktimin dhe përzgjedhjen e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huaja do të kryhet në përputhje me parimin e konkurrencës, mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë të ofertuesve, si dhe konfidencialitetit.

3. Institucioni i Avokaturës së Shtetit, në kuadër të ofrimit të asistencës juridike për personat juridikë publikë, të përcaktuar në nenin 5, pika 1/1, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, ose në raste të tjera në kuadër të ushtrimit të kompetencave për mbrojtjen e interesit pasuror të Republikës së Shqipërisë, përzgjedh dhe kontrakton avokatë ose zyra avokatie vendase ose të huaja.

4. Personat juridikë publikë, të përcaktuar në nenin 5, pika 1/1, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, me kërkesë të motivuar, drejtuar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, duhet të parashtrojnë nevojën për asistencë juridike. Në çdo rast, kërkesa, drejtuar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, duhet të përmbajë:

a) argumentimin e fakteve e të rrethanave që kanë çuar në këtë kërkesë, si dhe nevojën apo natyrën e asistencës juridike të kërkuar;

b) identifikimin, për aq sa është e mundur në këtë fazë të procesit, të çështjeve apo të detyrave konkrete, të cilat duhet të plotësohen nga avokati apo zyra e avokatisë vendase ose e huaj;

c) angazhimin dhe përshkrimin e masave, të cilat do të ndërmerren nga ana e personit juridik për përballimin e të gjitha shpenzimeve ekonomike, të cilat do të rezultojnë në kuadër të ofrimit të asistencës juridike.

5. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit shprehet lidhur me kërkesën e paraqitur nga ana e personit juridik, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e saj, duke arsyetuar vendimmarrjen e tij mbështetur në këto kritere:

a) Çështja është me rëndësi të veçantë për interesat pasurorë të personit juridik apo të Republikës së Shqipërisë;

b) Çështja ka një natyrë të veçantë e të ndërlikuar juridike dhe kërkon njohuri juridike të specializuara në një fushë apo legjislacion të caktuar;

c) Çështja ka si objekt dëmshpërblimin për shuma më të mëdha se 100 000 000 (njëqind milionë) lekë;

ç) Në raste të tjera të veçanta të çmuara nga personi juridik ose Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

6. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit nxjerr urdhër për fillimin e procedurës së konkurrimit për përzgjedhjen dhe kontraktimin e avokatit ose të zyrës së avokatisë vendase ose të huaj, duke përcaktuar, në çdo rast:

a) nevojën për asistencë juridike dhe kontraktimin e avokatit ose të zyrës së avokatisë vendase ose të huaj;

b) objektin e procedurës së konkurrimit, si dhe llojin e shërbimit të kërkuar;

c) komisionin për hartimin e ftesës për ofertë dhe zhvillimin e procedurës së konkurrimit e të përzgjedhjes së ofertuesit.

7. Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, me përfaqësues të Avokaturës së Shtetit, ku njëri prej tyre është kryetari. Komisioni, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e hyrjes në fuqi e urdhrit të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, i dërgon me shkrim/elektronikisht ftesën për ofertë avokatit apo zyrave të avokatisë vendase apo të huaja që janë renditur në udhërrëfyes ndërkombëtarë të njohur në këtë fushë.

8. Komisioni publikon gjithashtu në faqen zyrtare të Avokaturës së Shtetit njoftimin për nevojën për kontraktimin e avokatëve apo të zyrave të avokatisë. Njoftimi përmban të gjithë informacionin e nevojshëm që u jep mundësi subjekteve të interesuara të shprehin interesin nëse do të marrin pjesë ose jo në këtë procedurë konkurrimi. Në vijim të shprehjes së interesit për të marrë pjesë në këtë procedurë konkurrimi, komisioni i dërgon me shkrim/elektronikisht ftesën për ofertë subjektit të interesuar.

9. Afati kohor minimal për dorëzimin e ofertave është 5 (pesë) ditë pune nga dita kur është shpallur njoftimi në faqen zyrtare të Avokaturës së Shtetit. Megjithatë, në varësi të natyrës e të llojit të shërbimit, objekt i procedurës së konkurrimit, komisioni mund të caktojë një afat më të gjatë për dorëzimin dhe hapjen e ofertave.

10. Ftesa për ofertë duhet të përmbajë të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që t'u mundësojë subjekteve të interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre. Ky informacion duhet të përmbajë:

a) një referencë për njoftimin e publikuar të procedurës së konkurrimit;

b) objektin e procedurës së konkurrimit, si dhe llojin e shërbimit të kërkuar;

c) kriteret e kualifikimit që duhet të plotësohen nga avokatët apo zyrat e avokatisë në kuadër të këtij procesi konkurrimi, si dhe kriteret e vlerësimit për përzgjedhjen e ofertës fituese;

ç) vendin, datën dhe orën për dorëzimin e hapjen e ofertave;

d) gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumentacionit shoqërues;

dh) informacione të tjera që komisioni i vlerëson të nevojshme.

11. Subjektet e interesuara mund të kërkojnë sqarime për informacionet e dhëna në ftesën për ofertë. Komisioni i jep këto sqarime dhe ua dërgon të gjitha subjekteve me shkrim/elektronikisht, të cilave u është dërguar ftesa për ofertë. Nëse është e nevojshme, komisioni zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertave.

12. Kriteret e kualifikimit të përcaktuara në ftesën për ofertë përmbajnë listën e dokumentacionit ligjor dhe/ose administrativ të ofertuesve për të marrë pjesë në procesin e konkurrimit. Për të marrë pjesë në një procedurë konkurrimi, ofertuesi duhet të dorëzojë:

a) dokumentin që vërteton se ofertuesi është regjistruar në regjistrat përkatës profesionalë dhe tregtarë të shtetit, në të cilin është themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tij ligjor;

b) dokumentin që vërteton se ofertuesi nuk është në proces falimentimi apo kapitalet dhe asetet nuk janë në proces ekzekutimi nga ana e përmbaruesit gjyqësor apo ekziston një urdhër sekuestroje për to;

c) dokumentin që vërteton se ofertuesi nuk është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra penale që lidhen me aktivitetin e tij profesional;

ç) certifikatën ISSO 27001 në emër të ofertuesit, që vërteton se ofertuesi aplikon standardet e sigurisë së informacionit, lëshuar

nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar.

13. Kriteret për kualifikim janë të njëjta për çdo procedurë konkurrimi. Ofertuesi duhet të vërtetojë se i plotëson kërkesat për kualifikim të parashikuara në shkronjat "a", "b" e "c", të pikës 12, të këtij vendimi, me dokumente të lëshuara jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e hapjes së ofertave. Ofertuesit, shtetet e të cilëve nuk lëshojnë këto dokumente, janë të detyruar të paraqesin për përmbushjen e kritereve të kualifikimit një vetëdeklaratë me shkrim.

14. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar dhe shoqëruar, sipas rastit, me vulë apostile, sipas kërkesave të ligjit nr. 9060, datë 8.5.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja". Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti ose të dokumenteve të pasakta përbëjnë shkak për shkualifikimin e ofertuesit.

15. Kriteret e vlerësimit për përzgjedhjen e ofertës fituese janë të njëjta për çdo procedurë konkurrimi. Komisioni zbaton kriteret e vlerësimit me qëllim vlerësimin e ofertës nga pikëpamja ekonomiko-teknike, si:

a) Oferta ekonomike;

b) Përvoja profesionale e ofertuesit;

c) Eksperienca të ngjashme të stafit kryesor të propozuar me natyrën e mosmarrëveshjes dhe/ose të shërbimit të kërkuar;

ç) Raste të suksesit në procedime të ngjashme me objektin e procedurës së konkurrimit.

16. Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur, në adresën e përcaktuar në ftesën për ofertë, brenda afatit kohor, të përcaktuar si afati i fundit për dorëzimin e tyre. Çdo ofertë e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë nuk shqyrtohet nga komisioni dhe i kthehet e pahapur ofertuesit.

17. Komisioni hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose pas mbarimit të afatit përfundimtar, të përcaktuar pas zgjatjes së këtij afati, në përputhje me procedurat e specifikuara në ftesën për ofertë.

18. Komisioni, brenda 5 (pesë) ditëve pune, verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në pikën 12, të këtij vendimi. Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së ofertuesit fitues në një procedurë konkurrimi, duhet të pranohet të paktën 1 (një) ofertë e kualifikuar. Në të kundërt, komisioni anulon procedurën dhe fillon një procedurë të re konkurrimi.

19. Për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave, komisioni, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime me shkrim/elektronikisht për ofertat e tyre. Në çdo rast, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet apo të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

20. Komisioni mund të korrigjojë ato gabime në propozimin ekonomik, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të propozimeve. Komisioni njofton menjëherë ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronikisht për çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që ofertuesi ta ketë miratuar këtë ndryshim. Nëse ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë propozimi do të refuzohet.

21. Komisioni vijon vlerësimin e propozimeve ekonomiko-teknike vetëm të ofertuesve të kualifikuar. Vlerësimi i propozimeve ekonomiko-teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret, si më poshtë vijon:

a) Oferta ekonomike, së cilës i bashkëlidhet një listë e detajuar çmimesh, ku do të pasqyrohen pagesat e shërbimit të konsulencës dhe shpenzimet e tjera, si: shpenzimet për udhëtime, për printimin e raporteve e shpenzime sekretarie. Ofertuesi duhet të dorëzojë çmimin total të propozimit pa TVSH-në, si dhe vlerën e TVSH-së si zë më vete, nëse është e aplikueshme. Të gjitha çmimet e propozuara duhet të jenë fikse dhe jo objekt rishikimi. Propozimit me çmimin më të ulët i jepet vlerësimi maksimal prej 40 pikësh, ndërsa propozimeve të tjera u jepen vlerësime, ku çmimet e tyre janë në përpjesëtim të zhdrejtë me çmimin më të ulët, sipas formulës: Pikët për propozimin ekonomik = 40 x çmimin më të ulët të ofruar/çmimi ofertues i radhës.

b) Përvoja profesionale e ofertuesit. Për vlerësimin e këtij kriteri, në rastin e përfaqësimit

ligjor, do të shërbejë numri i rasteve apo i çështjeve, ku ofertuesi është angazhuar përpara dhomës përkatëse të arbitrazhit, ndërsa në rastet e kontratave me objekt dhënien e asistencës juridike, do të shërbejë numri i rasteve apo i çështjeve, ku ofertuesi ka realizuar shërbime të ngjashme me objektin e procedurës së konkurrimit. Propozimit me numrin më të madh të rasteve i jepet vlerësimi maksimal prej 20 pikësh, ndërsa propozimeve të tjera u jepet vlerësim, ku numri i rasteve të paraqitura është në përpjesëtim të zhdrejtë me numrin më të madh, sipas formulës: Pikët për përvojën profesionale = 20 x numrin më të madh të rasteve/numrin e propozimit të radhës.

c) Eksperienca të ngjashme të stafit kryesor të ofertuesit që do të angazhohen në realizimin e objektit të kontratës. Për vlerësimin e këtij kriteri do të shërbejë numri i rasteve apo i çështjeve me natyrë të ngjashme me objektin e mosmarrëveshjes dhe/ose shërbimit të kërkuar në të cilat stafi është angazhuar. Propozimit me numrin më të madh të rasteve i jepet vlerësimi maksimal prej 20 pikësh, ndërsa propozimeve të tjera u jepet vlerësim, ku numri i rasteve të paraqitura është në përpjesëtim të zhdrejtë me numrin më të madh, sipas formulës: Pikët për eksperienca të ngjashme = 100 x numrin më të madh të eksperiencave/numrin e propozimit të radhës.

ç) Raste të suksesit të ofertuesit në procedime të ngjashme me objektin e procedurës së konkurrimit. Për vlerësimin e këtij kriteri do të shërbejë numri i përfaqësimeve ligjore / i dhënies së asistencës juridike për procedime të ngjashme me objektin e procedurës së konkurrimit. Propozimit me numrin më të madh të rasteve i jepet vlerësimi maksimal prej 20 pikësh, ndërsa propozimeve të tjera u jepet vlerësim, ku numri i rasteve të paraqitura është në përpjesëtim të zhdrejtë me numrin më të madh, sipas formulës: Pikët për raste suksesi = 20 x numrin më të madh të rasteve/numrin e propozimit të radhës.

22. Çdo kriter vlerësohet sipas metodës së vlerësimit të parashikuar në pikën 21, të këtij vendimi, dhe, më pas, pesha e tij kthehet në pikë përkatëse. Oferta ekonomikisht më e favorshme do të jetë oferta, e cila ka siguruar shumën më të madhe totale të pikëve të propozimit ekonomik dhe të propozimit teknik. Ofertuesi që ka marrë më shumë pikë gjatë mbledhjes së pikëve të propozimit ekonomik dhe propozimit teknik do të renditet i pari dhe, në vijim, ofertuesit e tjerë, sipas pikëve të siguruara.

23. Komisioni, gjatë shqyrtimit të ofertave, duhet të vlerësojë edhe mbi kushtet e konfliktit të interesit të ofertuesve, si më poshtë vijon:

a) Konfliktin ndërmjet ofertuesve. Ofertuesit nuk mund të konkurrojnë me të njëjtën përbërje të stafit. Për këtë qëllim, anëtarët e stafit të një ofertuesi duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e tyre për ofertuesin dhe mosangazhimin në stafin e ofertuesve të tjerë, kandidatë në të njëjtën procedurë konkurrimi;

b) Konfliktin ndërmjet objektit të procedurës së konkurrimit ose llojit të shërbimit të kërkuar. As ofertuesi dhe as ndonjëri prej anëtarëve të stafit të tyre nuk duhet të ofrojnë konsulencë për kryerjen e ndonjë detyre që për nga natyra e saj mund të jetë në konflikt me objektin e procedurës së konkurrimit ose llojin e shërbimit të kërkuar;

c) Marrëdhënien me stafin e Avokaturës së Shtetit ose personit juridik. Ofertuesit, përfshirë stafin e tyre, nuk duhet të jenë në kushtet e konfliktit të interesit në raport me anëtarët e komisionit apo zyrtarët e tjerë të përfshirë në këtë procedurë konkurrimi.

Për këtë qëllim, ofertuesi, stafi i tij, si dhe zyrtarët e përfshirë në një procedurë konkurrimi nënshkruajnë një deklaratë me anë të së cilës deklarojnë se nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit.

24. Në çdo rast, komisioni duhet të argumentojë e të dokumentojë lidhur me mënyrën e vlerësimit të ofertave dhe mënyrën e pikëzimit, sipas kritereve të këtij vendimi. Ky proces regjistrohet nëpërmjet procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim.

25. Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave komisioni njofton me shkrim/elektronikisht individualisht secilin ofertues lidhur me vlerësimin e ofertës së tij. Informacionet për shqyrtimin, sqarimin, vlerësimin dhe renditjen e ofertave apo rekomandimet për ofertën fituese nuk u bëhen të njohura ofertuesve ose personave të tjerë. Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë që të

sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje.

26. Çdo ofertues mund të paraqesë ankesë me shkrim/elektronikisht brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga marrja e njoftimit pranë Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Me marrjen e ankesës me shkrim/elektronikisht nga ofertuesi, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit urdhëron komisionin të pezullojë vazhdimin e procedurës së konkurrimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit shqyrton ankesën e paraqitur brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita e paraqitjes së saj.

27. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, me urdhër, ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim lidhur me këtë ankesë. Përjashtimisht, në rast të mungesës së personelit, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Vendimi i komisionit, nëpërmjet Avokatit të Përgjithshëm, i njoftohet komisionit të përzgjedhjes.

28. Komisioni, pas përfundimit të procedurave dhe të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Raporti përmbledhës duhet të përmbajë të paktën:

a) referencën për njoftimin e publikuar të procedurës së konkurrimit;

b) objektin e procedurës së konkurrimit, si dhe llojin e shërbimit të kërkuar;

c) ofertuesit e shkualifikuar dhe arsyet e shkualifikimit;

ç) ofertuesit e kualifikuar dhe mënyrën e vlerësimit të ofertave;

d) renditjen e ofertuesve dhe informacion, nëse ka pasur ankesa lidhur me to.

29. Pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes së ofertuesit, institucioni i Avokaturës së Shtetit fton ofertuesin e përzgjedhur për nënshkrimin e kontratës. Kur ofertuesi i suksesshëm nuk arrin të nënshkruajë kontratën, institucioni fton për lidhjen e kontratës ofertuesin vijues në klasifikimin e ofertuesve.

30. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit autorizon një avokat shteti për ndjekjen e çështjes deri në përfundim të saj, i cili do të ketë kryesisht funksione mbikëqyrjeje, koordinimi dhe komunikimi me avokatin ose zyrën e avokatisë së përzgjedhur, si dhe personin juridik përkatës. Pas lidhjes së kontratës, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit merr masa për të pajisur avokatin ose zyrën e avokatisë së përzgjedhur me autorizimin përkatës.

31. Në të njëjtën kohë, titullari i personit juridik autorizon një nëpunës të nivelit të lartë drejtues për ndjekjen e çështjes, deri në përfundim të saj, i cili do të ketë kryesisht funksione mbikëqyrjeje, koordinimi dhe komunikimi me Avokaturën e Shtetit e me subjektin e përzgjedhur.

32. Krerët III e IV, të vendimit nr. 392, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores "Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale"", shfuqizohen.

33. Ngarkohet Avokatura e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 382, datë 12.6.2019

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË NJË ANËTARI TË KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin e z. Eltar Deda në detyrën e anëtarit të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 383, datë 12.6.2019

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2019, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES, PËR KOMPENSIMIN E VEÇANTË TË FAMILJEVE TË USHTARAKËVE TË RËNË NË KRYE TË DETYRËS, GJATË PËRMBUSHJES SË MISIONIT USHTARAK, JASHTË VENDIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për kompensimin e veçantë të familjeve të ushtarakëve nëntetar Zarife Muharrem Hasanaj dhe major Klodian Nikolla Tanushi, të cilët humbën jetën gjatë kryerjes së detyrës, në mision ushtarak, jashtë vendit.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2019.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 384, datë 12.6.2019

PËR PËRCAKTIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR TË PËRFITUAR STREHIM SIPAS ÇDO PROGRAMI SOCIAL TË STREHIMIT DHE TË AFATEVE E TË PROCEDURAVE TË MIRATIMIT NGA ORGANET E VETËQEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfshirja në programet sociale të strehimit bëhet nëpërmjet aplikimit në strukturën përgjegjëse për strehimin të njësisë së vetëqeverisjes vendore të vendbanimit të aplikantit.

2. Të drejtën për aplikim për përfitimin nga programet sociale e kanë individët që kanë mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, kujdestarët ligjor për rastet e personave të vendosur në kujdestari ligjore, për shkak të heqjes apo kufizimit të zotësisë për të vepruar, dhe familjet që janë të regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësinë e vetëqeverisjes vendore përkatëse, të cilat, në momentin e aplikimit, plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikat 1, 2, 3 e 4, të nenit 13, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social". Të drejtën për aplikim e kanë edhe individët/familjet rome të paregjistruar/a në zyrën e gjendjes civile të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku aplikojnë, për të cilët njësia e vetëqeverisjes vendore ka informacion se banojnë në atë njësi të vetëqeverisjes vendore.

3. Aplikimi i të miturve nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, pas lirimit ose përfundimit të

programit të masës alternative të shmangies, në rastet kur, bazuar në një vendim gjyqësor ose një akt administrativ, mbeten të pastrehë për arsye se nuk duhet të jetojnë me prindërit, kujdestarin ligjor ose me familjen e tyre, bëhet me kërkesën e një përfaqësuesi të caktuar me vendim gjykate ose akt administrativ.

4. Aplikimi për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit, me përjashtim të rasteve të nevojës emergjente për strehim, bëhet me dy faza. Në fazën e parë aplikantët paraqesin kërkesën e tyre për të përfituar nga programet e strehimit social, sipas ligjit nr. 22/2018. Në fazën e dytë të aplikimit përfshihen vetëm ata/o individë/familje që janë përzgjedhur për t'u trajtuar me njërin prej programeve të strehimit.

5. Individi/familja paraqet kërkesën për të përfituar nga programet e strehimit social në çdo kohë, sipas formatit të miratuar nga këshilli bashkiak, bazuar në modelin që i bashkëlidhet këtij vendimi, si shtojca "A" dhe sipas deklarimit tip për vërtetësinë e të dhënave që i bashkëlidhet këtij vendimi, si shtojca "B". Për paraqitjen e kërkesave verbale, struktura përgjegjëse për strehimin mund të caktojë një orar të posaçëm brenda orarit zyrtar të punës së njësisë së vetëqeverisjes vendore. Ky orar bëhet publik edhe në faqen e internetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

6. Aplikimi paraqitet drejtpërdrejt në strukturën përgjegjëse për strehimin të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose në zyrën e qëndrimit me një ndalesë të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në rast se ka një të tillë. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të vendosin që kërkesa të tilla të paraqiten pranë njësive administrative më të afërta me qendrën e banimit të personave që paraqesin kërkesën, duke përcaktuar edhe kompetencat e tyre në përputhje me legjislacionin për vetëqeverisjen vendore. Personat që ekzekutojnë dënimin penal me burgim mund ta paraqesin kërkesën pranë institucionit ku gjenden të ndaluar ose ku ekzekutojnë dënimin penal me burgim.

7. Aplikimet për përfitimin nga programet sociale regjistrohen dhe përpunohen nga strukturat përgjegjëse për strehimin në njësitë e vetëqeverisjes vendore në një sistem elektronik. Aplikimet mund të jenë:

a) në formë të shkruar;

b) në formë të shkruar elektronike në adresën e postës elektronike, që çdo njësi e vetëqeverisjes vendore bën publike për aplikimin për përfitimin nga programet e strehimit përmes njoftimit në faqen e saj të internetit dhe njoftimit publik;

c) në formë deklarate verbale para strukturës përgjegjëse për strehimin ose zyrës së qëndrimit me një ndalesë, kur ka të tillë, e që regjistrohet nga kjo strukturë apo zyrë.

8. Strukturat përgjegjëse për strehimin bëjnë përzgjedhjen e kërkesave pa të meta dhe i regjistrojnë sipas rendit kronologjik në sistemin e posaçëm elektronik. Regjistri i kërkesave përmban informacionin që mundëson përpunimin e të dhënave, si më poshtë vijon:

a) Identitetin, emrin, atësinë, mbiemrin;

b) Numrin e kërkesës;

c) Datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit;

ç) Objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për programin e strehimit social;

d) Numrin dhe emërtimin e dokumenteve që i bashkëngjiten kërkesës;

dh) Adresën e kërkuesit;

e) Përbërjen familjare në momentin e aplikimit;

ë) Statusin e punësimit;

f) Kushtin social, sipas nënndarjeve "i" deri në "xv", të shkronjës "c", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018;

g) Kushtin e strehimit, sipas nënndarjeve "i" deri në "vi", të shkronjës "a", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018;

gj) Kushtin familjar, sipas nënndarjeve "i" deri në "iv", të shkronjës "b", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018;

h) Kushtin ekonomik, ku evidentohen të ardhurat mujore të familjes, sipas përcaktimit të pikës 44, të nenit 2, të ligjit nr. 22/2018.

9. Në qoftë se kërkesa e aplikantit ka të meta dhe mangësi të të dhënave të kërkuara nga ky vendim, struktura përgjegjëse për strehimin, brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës, i kërkon me shkrim aplikantit të korrigjojë pasaktësitë, duke përcaktuar edhe afatin e nevojshëm për plotësimin e tyre. Kur kërkuesi nuk plotëson pasaktësitë brenda afatit të caktuar, kërkesa quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet aplikantit.

10. Çdo individi/familjeje që paraqet kërkesën, në çdo rast, i lëshohet një vërtetim që konfirmon regjistrimin e kërkesës, objektin e saj, datën dhe listën e dokumenteve të bashkëlidhura, nëse ka të

tilla, sipas formatit që i bashkëlidhet këtij vendimi, si shtojca "C". Ky vërtetim lëshohet edhe kur kërkesa paraqitet në formë elektronike ose me postë. Në rastet kur aplikimet janë verbale, aplikantit i lëshohet menjëherë një vërtetim për regjistrimin e aplikimit. Në rastin kur aplikimi bëhet me shkrim apo edhe elektronik, aplikantit i dërgohet në adresën e dhënë të komunikimit ose në adresën elektronike, nëse ai ka dhënë pëlqimin për përdorimin e një adrese elektronike për komunikim, vërtetimi për regjistrimin e aplikimit.

11. Strukturat përgjegjëse për strehimin ose zyra e shërbimit me një ndalesë ofron ndihmë aktive për plotësimin e formularëve të aplikimit për përfitimin nga programet e strehimit social për cilindo aplikues, duke u kujdesur veçanërisht për individët me aftësi të kufizuar në të parë e në të folur nëpërmjet interpretuesit të gjuhës së shenjave ose lehtësuesit të komunikimit, të moshuarit, personat që nuk kuptojnë gjuhën shqipe ose ata që nuk dinë shkrim e këndim, si dhe siguron që çdo individ/familje që ka vështirësi komunikimi, për shkak të gjendjes shëndetësore ose sociale, të marrë informacionin e ndihmën e nevojshme për këtë qëllim.

12. Faza e dytë e aplikimit fillon kur njësia e vetëqeverisjes vendore planifikon zbatimin e njërit prej programeve apo instrumenteve të strehimit social. Bazuar në kërkesat specifike të çdo programi, njësia e vetëqeverisjes vendore ndjek procedurat, si më poshtë vijon:

a) Miraton çdo vit sistemin e pikëzimit;

b) Klasifikon kërkesat për strehim sipas sistemit të pikëzimit;

c) Njofton subjektet që janë përzgjedhur për t'u trajtuar me një program për plotësimin e dokumentacionit, duke i njoftuar, në çdo rast, edhe afatin për plotësimin e dokumentacionit;

ç) Mbledh cilindo prej dokumenteve të përmendura në pikën 16, të këtij vendimi, që e mbajnë organet publike në vend, duke përjashtuar aplikantin nga detyrimi për paraqitjen e tyre;

d) Bën verifikimin e dokumentacionit, sipas pikës 16, të këtij vendimi, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e dorëzimit;

dh) Harton dhe miraton listën e përfituesve, mbështetur në klasifikimin e kërkesave;

e) Njofton individët/familjet që përfitojnë nga programet specifike të strehimit, si dhe ata/o që nuk kanë përfituar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit të listës së përfituesve nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore të përfituesve.

13. Njësia e vetëqeverisjes vendore garanton që viktimat e dhunës në familje të përfitojnë nga njëri prej programeve sociale të strehimit. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, për strehimin e viktimave të dhunës në familje, vendos, me procedurë të përshpejtuar, menjëherë me paraqitjen e rastit për vendimmarrje.

14. Aplikantëve jofitues, struktura përgjegjëse për strehimin u njofton edhe arsyet e kësaj vendimmarrjeje. Vendimet e marra përfshijnë edhe përcaktimin e mjetit ligjor mbrojtës, gjykatën kompetente, si dhe afatet kohore për ushtrimin e këtij mjeti mbrojtës. Aplikantët jofitues mund të paraqesin ankesat e tyre pranë kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, por kjo nuk pengon ushtrimin e mjetit ligjor mbrojtës pranë gjykatës kompetente.

15. Aplikantët mund të refuzojnë programin e strehimit dhe të mbeten përsëri në listën e pritjes, vetëm kur nuk u plotësohet strehimi sipas normave në fuqi.

16. Në fazën e dytë, dosja e çdo aplikanti duhet të përmbajë dokumentacionin që vërteton deklarimet e bëra në fazën e parë. Dokumentacioni që kërkohet në këtë fazë është, si më poshtë vijon:

a) Për të dhëna personale të aplikantit:

i) certifikatë e lindjes së aplikantit, me përjashtim të rasteve specifike kur individi/familja nuk ka regjistrim në gjendjen civile;

ii) vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku kërkohet strehimi social, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit.

b) Për vërtetimin e kushteve të strehimit, sipas shkronjës "a", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social":

i) vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes;

ii) vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat e strehimit në fuqi;

iii) vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për çdo anëtar të familjes, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi;

iv) aktverifikim nga njësia vendore për:

- banesat në rrezik shembjeje;

- rastet kur familja ka mbetur e pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore;

- banesat që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit.

v) Vendim i gjykatës për familjet që humbasin banesën për shkak të zbatimit të vendimit të gjykatës;

vi) akt i verifikimit nga njësia vendore për familjet rome/egjiptiane, që banojnë në banesa individuale ose struktura, të cilat nuk klasifikohen si banesë.

c) Për vërtetimin e kushteve familjare, sipas shkronjës "b", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social":

i) certifikatë familjare;

ii) vendim i gjykatës që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara.

ç) Për vërtetimin e kushteve sociale, sipas shkronjës "c", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social":

i) vërtetim i komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar për individë me aftësi të kufizuara;

ii) vërtetim përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezë e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar për individët me statusin e jetimit;

iii) dokument që vërteton se ka mbetur i pastrehë si rezultat i lirimit të banesave, ish-pronë e subjekteve të shpronësuara;

iv) dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin "emigrant", "punëtor emigrant" dhe "azilkërkues";

v) dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të shtetit dhe të Policisë së Burgjeve;

vi) urdhër mbrojtjeje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, lëshuar nga gjykata për viktimat e dhunës në familje;

vii) vetëdeklarim nëse individi/familja i përket pakicës kombëtare rome ose egjiptiane;

viii) dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin;

ix) vetëdeklarim se i përket grupimit LGBTI;

x) vërtetim me certifikatë familjare se individi i përket kategorisë vajzë-nënë.

d) Për vërtetimin e kushteve ekonomike, sipas shkronjës "ç", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social":

i) vërtetim i të ardhurave neto të familjes ose një deklaratë me shkrim nga aplikuesi për të ardhurat e familjes dhe burimin e tyre, të cilat duhet t'i bashkëlidhen dokumenteve zyrtare që e vërtetojnë atë, përfshirë vërtetimin nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;

ii) dokument nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes;

iii) vërtetim nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për anëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;

iv) vërtetim nga zyra e punësimit e njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë;

v) vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.

17. Dokumentacioni i parashikuar në shkronjën "ç", nënndarjet "vii", "ix" e "x", si dhe në nënndarjen "i", të shkronjës "d", të pikës 16, të këtij vendimi, dorëzohet nga vetë aplikanti, me përjashtim të rasteve kur sigurimi i tyre është i pamundur për shkak të situatave të dhunës në familje, e vërtetuar me urdhër mbrojtjeje apo urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, lëshuar nga gjykata. Për aplikantët viktima të dhunës në familje të dhunuara kërkohet vetëm dokumentacioni sipas pikës 16, të nënndarjes "vi", të shkronjës "d". Dokumentacioni tjetër i parashikuar në pikën 16, të këtij vendimi, që mbajnë apo përgatisin organet publike në vend, sigurohet nga vetë struktura përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, duke përjashtuar aplikantin nga detyrimi për paraqitjen e tyre, vetëm nëse aplikanti depoziton deklaratën e pëlqimit për mbledhjen e informacioneve/dokumenteve të lidhura me të, sipas formatit tip që i bashkëlidhet këtij vendimi, si shtojca "Ç". Nëse aplikanti nuk e dorëzon apo refuzon të firmosë këtë deklaratë, struktura përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes

vendore shkarkohet nga detyrimi i mbledhjes së dokumentacionit dhe ky detyrim i kalon vetë aplikantit. Dokumentacioni i nevojshëm sigurohet me shpenzimet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 14, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social". Njësia e vetëqeverisjes vendore, me qëllim lehtësimin e marrjes së dokumentacionit të parashikuar sipas kësaj pike dhe pikës 16, të këtij vendimi, lidh, kur është e nevojshme, marrëveshje me strukturat përkatëse.

18. Struktura përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, menjëherë, por jo më vonë se brenda 3 (tri) ditëve pas hartimit të listës përfundimtare të aplikantëve, ia dërgon atë për miratim këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, i cili e shqyrton atë dhe merr vendim në mbledhjen e radhës.

19. Aplikantët që janë në kushtet e nevojës emergjente për strehim, që banojnë në banesa në rrezik shembjeje, në banesa që nuk plotësojnë kushtet higjieno-sanitare, në banesa që prishen për shkak të ndërtimeve të veprave publike, të cilët nuk përfitojnë kompensim financiar nga procedurat e shpronësimit, ose që kanë mbetur pa strehë për shkak të fatkeqësive natyrore, si dhe personat e pastrehë, paraqesin kërkesën dhe deklaratën sipas pikës 5, të këtij vendimi, duke specifikuar edhe situatën në të cilën gjenden. Struktura përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore shqyrton menjëherë kërkesën dhe, brenda 24 (njëzet e katër) orëve, verifikon situatën në terren. Gjendja e verifikuar pasqyrohet në një procesverbal që mbahet nga struktura përgjegjëse për strehimin dhe firmoset edhe nga aplikanti. Kur rastet e emergjencës për strehim identifikohen nga vetë njësia e vetëqeverisjes vendore, ajo nis procedurën duke njoftuar individët/familjet për strehimin për shkak të situatës emergjente. Në të gjitha situatat e gjendjes së emergjencës, kur procedura fillon me kërkesë të individit/familjes përfituese, ose kryesisht nga vetë njësia e vetëqeverisjes vendore, emri/at / lista e aplikantëve paraqitet/n menjëherë në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për miratim.

20. Organet e vetëqeverisjes vendore bëjnë publike, çdo vit, nëpërmjet mjeteve të informimit publik në faqet e tyre të internetit dhe shpalljes në vende të dukshme, pranë institucionit të tyre, këto të dhëna:

a) Kërkesat që duhen plotësuar për t'u trajtuar me një program specifik strehimi dhe sistemin e pikëzimit, të miratuara nga këshilli bashkiak;

b) Vendndodhjen e banesave, të ndërtuara apo të blera në treg, që do të përdoren si banesë sociale me qira, dhe vendndodhjen e banesave, që mund të shfrytëzohen për subvencionin e qirasë ose uzufruktit;

c) Personin përgjegjës me të cilin duhet kontaktuar për plotësimin dhe ndryshimin e të dhënave të formularit apo për çdo sqarim tjetër për plotësimin e tij;

ç) Dokumentacionin që kërkohet për verifikimin e të dhënave që deklaron subjekti i interesuar;

d) Procedurën që do të ndiqet nga njësia e vetëqeverisjes vendore për miratimin e përfituesve;

dh) Organin ankimor, të cilit duhet t'i drejtohet subjekti që nuk është përzgjedhur si fitues, si dhe afatet kohore.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin të gjitha masat e mundshme që informimi publik të jetë i aksesueshëm dhe i kuptueshëm edhe nga grupet vulnerabël. Ato informojnë organizatat e shoqërisë civile që bashkëpunojnë me njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe veprimtaria e të cilave lidhet me çështjet apo grupimet, subjekt i këtij vendimi.

21. Struktura përgjegjëse për strehimin në njësitë e vetëqeverisjes vendore harton, administron dhe përditëson regjistrin e individit/familjeve në listat pritëse.

22. Njësitë e vetëqeverisjes vendore informojnë çdo vit ministrinë përgjegjëse për strehimin për nevojat për strehim, të identifikuara në përputhje me këtë vendim, nëpërmjet aplikimeve për strehim social.

23. Individi/familjet, i cili/të cilat ka/në aplikuar sipas akteve ligjore në fuqi, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", dhe që nuk është/janë trajtuar me strehim, vijon/vijojnë të jetë/jenë i/të përfshirë/a në listën e aplikantit/aplikantëve për programet e strehimit.

24. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCA "A"

KËRKESA PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL

KËRKESË

PËR T'U TRAJTUAR ME STREHIM, BAZUAR NË LIGJIN NR. 22/2018, "PËR STREHIMIN SOCIAL"

FAZA E PARË E APLIKIMIT

Mbiemri …….emri……datëlindja……
Qyteti …… Njësia administrative …….. Rruga……
Pall. …… Shk. ….. Ap. ….. (Në rastin e një banese private) Nr…….. Tel…….

I. GJENDJA FAMILJARE

MBIEMRI	EMRI	DATËLINDJA Dita/Muaji/Viti (00/00/0000)	(1) SEKSI	(2) GJENDJA CIVILE	Nr. DOKUMENTI I IDENTIFIKIMIT	(3) FAMILJARËT	(4) PUNËSIMI

Në tabelë hidhen kodet, si më poshtë vijon:

1. SEKSI		2. GJENDJA CIVILE		3. FAMILJARËT		4. PUNËSIMI	
Mashkull	(M)	Beqar/e		1 Aplikanti	00	Punësuar në shtet	01
Femër	(F)	i/e martuar		2 Nëna/Babai	01	Punësuar në privat	02
Nuk		i/e ve		3 Bashkëshorti/ja	02	I/E vetëpunësuar	03
Përgjigjem	(N)	i/e divorcuar		4 I biri/E bija	04	Punësim i rastit	04
				Gjysh/e	05	I përfshirë në programin e ndihmës ekonomike	05
				Nip/Mbesë	06	I përfshirë në programin e pagesës së papunësisë	06
				Vjehrri/a	07	Të tjerë	07
				Dhëndri/nusja	08		
				Vëllai/motra	09		
				Kunati/a	10		
				Të tjerë	11		

Shënim: Në kolonat 1, 2, 3 e 4 vendos numrin që i korrespondon gjendjes suaj. Të dhënat e kolonës 3 duhet të korrespondojnë me certifikatën familjare.

II. KUSHTET E STREHIMIT

Po Jo

2. Disponon banesë në pronësi……

2.1. Nëse **PO**, jep informacionin e saktë për: ☐ ☐

- Prona është e regjistruar në emër të (vendos referencën sipas kolonës 3, të tabelës "Gjendja familjare") _____

- Prona ka një strukturë:
  - garsoniere …… ☐
  - struktura e apartamentit 1+1 …… ☐

struktura e apartamentit 2+1…… ☐

  - struktura e apartamentit 3+1…… ☐
  - Sipërfaqja totale e banesës sipas dokumentit të pronësisë ……

- Sipërfaqja totale e banimit[1]……

2.2. Nëse jeni përgjigjur negativisht në pikën 2, vazhdoni me plotësimin e informacionit, si më poshtë vijon:

- Banoj me qira ……. ☐
- Banoj me prindërit ..... ☐
- Banoj në banesë informale ..... ☐

2.3 Banoj në banesë rrezik shembjeje ☐
.....

2.4 Banoj në banesë të mbipopulluar ☐
.....

2.5 Kam mbetur i pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore ☐
.....

2.6 Kam mbetur i pastrehë nga procese gjyqësore ☐
.....

2.7 Banoj në banesë që prishet/përjashtohet nga legalizimi ☐
.....

III. KUSHTET FAMILJARE

Shëno vetëm në një kuti që i përshtatet kushtit tuaj familjar

3.1 Familje një prindërore që kam në ngarkim fëmijë …… ☐

3.2 I/E moshuar që kam mbushur moshën e pensionit dhe nuk jam përzgjedhur për t'u strehuar në një institucion publik të përkujdesjes shoqërore……..... ☐

3.3 Familje me më shumë se 4 fëmijë …… ☐

3.4 Çift me moshë jo më të madhe se 60 vjeç …….. ☐

[1] Në sipërfaqen totale të banimit përfshihen sipërfaqja e dhomave të gjumit plus sipërfaqen e dhomës së ditës, të matura brenda mureve ndarëse.

IV. KUSHTET SOCIALE

Shëno në kutitë që u përshtaten kushteve tuaja sociale

4.1 Ka në përbërje familjare një individ me aftësi të kufizuara……. ☐

4.2 Ka statusin e jetimit dhe moshë deri në 30 vjeç …… ☐

4.3 Ka mbetur i pastrehë për shkak të lirimit të banesës ish-pronarëve …… ☐

4.4 Emigrant i rikthyer / punëtor emigrant ☐

4.5. Azilkërkues …… ☐

4.6 Familje e punonjësit të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë ……. ☐

4.7 Punonjës i Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH) ……. ☐

4.8 Punonjës i RENEA-s ……... ☐

4.9 Punonjës i Shpëtimit dhe i Mbrojtjes nga Zjarri …….. ☐

4.10 Viktimë e dhunës në familje …… ☐

4.11 Viktimë e trafikimit …… ☐

4.12 Anëtar i minoritetit rom ……. ☐

4.13 Anëtar i minoritetit egjiptian …… ☐

4.14 I mitur në konflikt me ligjin …… ☐

4.15 Vajza-nëna ……... ☐

4.16 Komuniteti LGBTI ……... ☐

4.17 Anëtar i familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike ……. ☐

V. TË ARDHURAT E FAMILJES

1. Ky seksion duhet të plotësohet për çdo person që siguron një të ardhur në familje, në përputhje me kolonat 3 e 4, të tabelës "Gjendja familjare". Në të ardhurat totale të familjes përfshihen të ardhurat neto nga punësimi, dypunësimi, pagesa e papunësisë, pagesa e ndihmës ekonomike, pensioni, dërgesa nga emigracioni, qira nga prona, transferta të tjera nga të afërm, si dhe çdo lloj e ardhure tjetër që sigurohet mbi baza mujore ose vjetore nga trashëgimi, interesa bankarë etj. Me të ardhura neto kuptohen të ardhurat pas shlyerjes së detyrimeve, si: taksa, tatime e sigurime shoqërore.
   - Të ardhurat totale mujore të familjes ……
   - Të dhëna të detajuara të të ardhurave mujore të familjarëve, sipas kolonës 3, të tabelës "Gjendja familjare"
   - 00 …….. 04 …… 08 …….
   - 01 …… 05 …… 09 …….
   - 02 …… 06 …… 10 …….
   - 03 …… 07 …….. 11 …….
   - Të ardhura nga emigracioni (vjetore) ……
   - Të ardhura nga qiraja (mujore) ……
   - Të ardhura të tjera (vjetore) ……

VI. FORMA E TRAJTIMIT SIPAS NJËRIT PREJ PROGRAMEVE SOCIALE TË STREHIMIT[2]

Unë dhe familja ime kërkojmë të trajtohemi me strehim nëpërmjet programit të:

(Rendit nga 1 deri në 4, sipas preferencës: 1 për preferencën më të madhe; 4 për atë më të ulët)

- Banesë sociale me qira …….……. ☐
- Përmirësimi i banesës ……..…… ☐
- Banesë me kosto të ulët …….….....….....…. ☐
- Tokë e pajisur me infrastrukturë për të ndërtuar vetë banesë ..... ☐

Shënim: *Forma e përfitimit mund të ndryshojë nga ajo që ju keni cilësuar si më të preferuarën, në varësi të mundësive të zgjidhjes dhe aftësisë financiare të familjes suaj për të përballuar kostot.*

Në mungesë të banesave sociale me qira dhe në mungesë të banesave me kosto të ulët, njësia e vetëqeverisjes vendore ofron një nga instrumentet e mëposhtme financiare. Nëse ju pranoni, duhet të shënoni:

	Pranoj	Nuk pranoj
– Në mungesë të banesave sociale, ofrohet subvencionimi i qirasë në tregun e lirë …….……	☐	☐
– Në mungesë të banesave me kosto të ulët, ofrohet, sipas mundësive buxhetore, subvencionimi i interesave të kredive....	☐	☐

SHTOJCA "B"

DEKLARATË E VËRTETËSISË SË INFORMACIONIT PARAPRAK

DEKLARATË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj sa më poshtë:

1. I gjithë informacioni i dhënë në formularin KËRKESË PËR TRAJTIM ME STREHIM është i vërtetë.
2. Pranoj që, në rast se përzgjidhem për t'u trajtuar me strehim, të bëhet inspektimi në banesën ku banoj dhe verifikimi i të gjithë informacionit të dhënë.
3. Jam në dijeni se, për çdo informacion të rremë, mua dhe anëtarëve të familjes sime u hiqet e drejta për të përfituar strehim.
4. Jam në dijeni se, nëse përzgjidhem për t'u trajtuar me strehim, struktura përgjegjëse për strehimin në bashki, bazuar në të dhënat mbi të ardhurat familjare, mund të më ofrojë një formë tjetër strehimi nga ajo që kam kërkuar në KREUN IV të këtij formulari.

Nënshkruar në _____, më _____

Deklaruesi: (Emër/Mbiemër/Firmë) _____

[2] Banesat e përkohshme dhe banesa e specializuar, si rregull, propozohen nga bashkia, për rastet e veçanta, dhe nuk ofrohen si alternativa

SHTOJCA "C":

VËRTETIM QË KONFIRMON REGJISTRIMIN E KËRKESËS, OBJEKTIN E SAJ, DATËN DHE LISTËN E DOKUMENTEVE TË BASHKËLIDHURA

Vërtetim regjistrimi kërkese

(NJËSIA E VETËQEVERISJES VENDORE)

Nr._____ Prot. ....., më _____/ _____201....

Lënda: Vërtetim regjistrimi kërkese për përfitimin nga programet e strehimit social

Drejtuar: Z./Znj. .....
(adresa)

I nderuar Z./Znj. ……,

Vërtetojmë se ju keni paraqitur kërkesën me nr. _____ protokolli, datë _____, e cila është regjistruar pa të meta pranë …… (njësia e vetëqeverisjes vendore), me anë të së cilës paraqisni preferencën tuaj për përfitimin nga programi _____ i strehimit social.

Kërkesa juaj është regjistruar me nr._____ në regjistrin elektronik të sistemit të pikëzimit. Bashkëlidhur kësaj kërkese janë depozituar edhe dokumentet, si më vijon:

	Titulli i dokumentit	Nr. i faqeve

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

_____
(emri i punonjësit, firma)

SHTOJCA "Ç"

DEKLARATË PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR LEJEN PËR MARRJEN E DOKUMENTACIONIT PËR FAZËN E DYTË TË APLIKIMIT

D E K L A R A T Ë

PËR
DHËNIEN E PËLQIMIT PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE, AKSESIN PËR NJOHJEN DHE ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Unë _____, i biri i/e bija e_____ dhe i/e _____ , lindur më _____, në _____, dhe banues/banuese në _____, me shtetësi _____, me numër identifikimi_____, me vullnetin tim të lirë,

D E K L A R O J S E:

Mbështetur dhe në zbatim të:

- Pikës 16, të vendimit nr._____, datë_____, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore";
- pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social";
- të neneve 2, 5 e 10, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale",

	Deklarimi	Firma (në kutinë që aplikanti dëshiron të plotësojë)
1.	- Jap pëlqimin që të mblidhen të dhënat e nevojshme, sipas parashikimeve të pikës 16, të vendimit nr. ___, datë _____, të Këshillit të Ministrave. - Jap pëlqimin që të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të këtyre të dhënave. - Jam dakord që të dhënat e mia personale të mbledhura në referim të pikës 16, të vendimit nr.___, datë_____, të Këshillit të Ministrave, të trajtohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për trajtimin e kërkesës sime për të përfituar strehim sipas programeve social të strehimit të parashikuar në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social.	
2.	- Nuk jap pëlqimin që të mblidhen të dhënat e nevojshme, sipas parashikimeve të pikës 16, të vendimit nr._____, datë _____, të Këshillit të Ministrave; - Nuk jap pëlqimin që të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të këtyre të dhënave. - Nuk jam dakord që të dhënat e mia personale të mbledhura, në referim të pikës 16, të vendimit nr.____, datë_____, të Këshillit të Ministrave, të trajtohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për trajtimin e kërkesës sime për të përfituar strehim sipas programeve sociale të strehimit të parashikuar në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social".	

_____ , më ___.___.20___

D E K L A R U E S I
(_____)

VENDIM
Nr. 387, datë 12.6.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 216, DATË 20.4.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË OSE TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË VITET E NDËRMJETME TË KËTYRE PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2018–2019"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 74, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Numrat rendorë 14 dhe 15, të tabelës në shtojcën 1, të vendimit nr. 216, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, për programet e studimit të ciklit të parë "Pedagogji Muzikore" dhe "Pikturë Grafike", në universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër, për vitin akademik 2018–2019, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 388, datë 12.6.2019

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE", TRUALL, TË PASURISË ME NUMËR 274/18, ZONA KADASTRALE 3115, BASHKIA PËRMET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me numër 274/18, zona kadastrale 3115, Bashkia Përmet, sipas certifikatës së pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, Qarku Gjirokastër, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit nga "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me numër 274/18, zona kadastrale 3115, Bashkia Përmet.

3. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të bëjë ndryshimin e llojit të pasurisë në certifikatën e pasurisë, sipas të dhënave për pasurinë e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Bashkia Përmet dhe Këshilli i Qarkut Gjirokastër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 1

Nr. Rend	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja në m²	Sipërfaqja që përdoret për zhvillim m²	Sipërfaqja ndërtimore m²	Emërtimi i Strukturës
1	Gjirokastër	Përmet	3115	Qilarisht	274/18	2575m²	2575 m²	780.90	Kantina Zavalani Farm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1076407
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. PËRMET Zona Kadastrale Nr. 115
Numri i Pasurisë 274/18 Volumi 6 Faqe 172
Adresa e Pasurisë QILARISHT
Lloji i Pasurisë ARE
Sipërfaqja Totale 2575.00 m2
Nga kjo : Sa Truall Nga kjo : Sa Ndërtesa -
Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
ARBEN	SABRI	HASANI	1/1	TIRANË

- është pronar i pasurisë me numër 274/18
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V _____, L _____, J _____, P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 6/6/2018 Nr. 601

Data e lëshimit të çertifikatës 6/8/2018

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
KASIL PANO


HARTE TREGUESE E REGJISTRIMIT
Fragment
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME PERMET
REGJISTRUESI
Vasil PANO
A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
ZONA KADASTRALE 3115 Nr. i pasurise 274/18 v. 6 Fq. 172
INDEKSI I HARTES K-34-137-(77-C) SHKALLA 1:2500
ADRESA E PASURISE Rrethi Permet P/G. Shk. K. Ap/Ni
RR/L
B. KUFIZIMET
V. 274/12
L. 274/6
J. 274/13; 274/14
P. 274/12
DATA 28/06/2018 Ora Nr. Kerkeses 601
ARBEN SABRI HASANI
C. PRONARI/ET
ILARISHT

VENDIM
Nr. 389, datë 12.6.2019

PËR KRITERET PËR LËSHIMIN E PASAPORTËS DIPLOMATIKE DHE ASAJ TË SHËRBIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 8668, datë 23.11.2000, "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pasaportat diplomatike dhe të shërbimit u lëshohen personave që u lind kjo e drejtë sipas parashikimeve ligjore apo nga ky vendim.

2. Për qëllime të këtij vendimi, "Pasaportë diplomatike apo shërbimi" është dokumenti i udhëtimit që vërteton identitetin dhe shtetësinë shqiptare të mbajtësve të saj dhe që lëshohet për kategoritë e përcaktuara në lidhjen 1 "Pasaportat diplomatike" dhe lidhjen 2 "Pasaportat e shërbimit", që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Në rastin kur mbajtësi i pasaportës diplomatike apo Shërbimit lë funksionin për të cilin është pajisur me këtë pasaportë, ajo duhet të dorëzohet brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike pranë ministrisë përgjegjëse për Punët e Jashtme, me përjashtim të rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

4. Institucionet publike njoftojnë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dorëzimi i detyrës, ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme për datën dhe emrin e subjektit që ka lënë funksionin, për të cilin është pajisur me pasaportë diplomatike apo shërbimi.

5. Pasaportat, të cilat nuk dorëzohen sipas afatit të përmendur në pikën 3, shpallen të pavlefshme nga ministria përgjegjëse për Punët e Jashtme.

6. Për pasaportat diplomatike apo të shërbimit të shpallura të pavlefshme sipas pikës 5, të këtij vendimi, ministria përgjegjëse për punët e jashtme njofton brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike të gjitha misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë të akredituara jashtë vendit dhe misionet e huaja të akredituara në Republikën e Shqipërisë për pavlefshmërinë e pasaportës së padorëzuar.

7. Njoftimi i përmendur në pikën 6 i përcillet, gjithashtu, Departamentit për Kufirin e Migracionin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, i cili urdhëron të gjitha pikat e kalimit kufitar për moslejimin e daljes jashtë shtetit të mbajtësit të pasaportës diplomatike apo të shërbimit, për bllokimin e pasaportës dhe kthimin e saj në ministrinë përgjegjëse për Punët e Jashtme.

8. Në rastin kur mbajtësi i pasaportës diplomatike apo të shërbimit e humbet atë gjatë periudhës, gjatë së cilës e gëzon këtë të drejtë, ripajiset me pasaportë të re, vetëm pasi institucioni përkatës ta ketë dërguar në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme:

a) kërkesën për ripajisjen me pasaportë diplomatike ose shërbimi;

b) deklaratën e personit ku sqaron rrethanat e humbjes;

c) denoncimin pranë autoritetit përgjegjës në Ministrinë e Brendshme ku të jetë konfirmuar se humbja e kësaj pasaporte iu është bërë e njohur të gjitha pikave të kalimit kufitar;

ç) denoncimin para autoritetit përgjegjës në shtetet e tjera ose misionin diplomatik apo konsullor të Republikës së Shqipërisë në një shtet tjetër për humbjen/vjedhjen e kësaj pasaporte.

9. Ngjyra e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit është e ndryshme nga ajo e pasaportave të zakonshme.

10. Formati ekzistues i pasaportës diplomatike dhe shërbimit është i vlefshëm deri në datën 31 dhjetor 2020.

11. Procedura dhe dokumentet që paraqiten për aplikim për pasaportë diplomatike apo shërbimi përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për Punët e Jashtme.

12. Institucionet publike mbulojnë nga buxheti i tyre kostot për pajisjen me pasaportat diplomatike apo të shërbimit të funksionarëve të tyre.

13. Vendimi nr. 335, datë 2.9.1997, i Këshillit të Ministrave, "Për pajisjen me pasaporta diplomatike dhe shërbimi", dhe aktet e tjera ndryshuese në zbatim të tij shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

14. Subjektet, që janë pajisur me pasaporta diplomatike apo shërbimi përpara hyrjes në fuqi

të këtij vendimi, kanë të drejtë të përdorin pasaportat përkatëse deri më datë 31 dhjetor 2019.

15. Ngarkohen ministria përgjegjëse për Punët e Jashtme, ministria përgjegjëse për Punët e Brendshme dhe institucionet e tjera publike, zyrtarët apo subjektet e të cilave pajisen me pasaporta diplomatike apo shërbimi sipas këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LIDHJA 1

Pajisen me pasaporta biometrike diplomatike subjektet e mëposhtme:

1. Presidenti;
2. Ish-Presidenti;
3. Kryetari Kuvendit;
4. Ish-Kryetari i Kuvendit;
5. Kryeministri;
6. Ish-Kryeministri;
7. Bashkëshortja/i e/i dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeç të:
a) Presidentit;
b) Kryetarit të Kuvendit;
c) Kryeministrit.
8. Bashkëshortja/i e/i deputetit;
9. Zëvendëskryeministri;
10. Anëtarët e Këshillit të Ministrave;
11. Deputeti;
12. Zëvendësministri;
13. Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës Kushtetuese;
14. Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës së Lartë;
15. Drejtuesi dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ);
16. Drejtuesi dhe anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP);
17. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi;
18. Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
19. Komisionerët Publikë;
20. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;
21. Kryetari dhe anëtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit;
22. Avokati i Popullit;
23. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
24. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ);
25. Drejtuesi dhe anëtarët e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK);
26. Prokurori i Përgjithshëm;
27. Sekretari i Përgjithshëm në institucionin e Presidentit, Kuvend, Kryeministri;
28. Drejtori i kabinetit në institucionin e Presidentit, Kuvend, Kryeministri, ministrinë përgjegjëse për Punët e Jashtme;
29. Këshilltarët në kabinetin e institucionit të Presidentit, Kuvend, Kryeministri, në rastet kur janë të ngarkuar me çështje diplomatike dhe protokollare, jo më shumë se tre këshilltarë për secilin institucion;
30. Këshilltarët e ministrit përgjegjës për punët e jashtme, kur janë diplomatë karriere;
31. Kryetari dhe nënkryetari i Shërbimit Informativ të Shtetit (SHISH);
32. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK);
33. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit;
34. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë;
35. Personeli diplomatik i Shërbimit të Jashtëm dhe familjarët e tyre, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë;
36. Funksionarët ndërkombëtarë, përfaqësues ose anëtarë të organizatave ndërkombëtare me shtetësi shqiptare, të emëruar ose të kandiduar nga shteti shqiptar;
37. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;
38. Oficeri i Ministrisë së Mbrojtjes, përfaqësues i Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare dhe familjarët e tyre, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë;
39. Oficer kontakti pranë ministrive homologe të shteteve të tjera, institucioneve ndërkombëtare, si dhe të atashuar pranë misioneve diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe familjarët e tyre, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë;

40. Korrieri diplomatik;
41. Komandanti i Gardës së Republikës;
42. Trup-rojë për sigurimin e:
a) Presidentit;
b) Kryetarit të Kuvendit;
c) Kryeministrit.
43. Personat që me ligj të posaçëm gëzojnë të drejtën për pajisjen me pasaportë diplomatike.
44. Funksionarët dhe nëpunësit publikë, me autorizim të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, për shkak të specifikës së funksionit apo detyrës shtetërore që kryejnë.

LIDHJA 2

Pajisen me pasaporta biometrike shërbimi, subjektet e mëposhtme:
1. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë;
2. Inspektori i Përgjithshëm i ILKPD-së;
3. Sekretari i Përgjithshëm në ministri dhe institucionet kushtetuese, të cilët nuk janë parashikuar në lidhjen 1;
4. Drejtori i kabinetit pranë Zëvendës-kryeministrit, në ministri dhe institucionet kushtetuese, të cilët nuk janë parashikuar në lidhjen 1;
5. Drejtorët e departamentit në Kryeministri;
6. Kryetari i bashkisë;
7. Prefekti;
8. Zëvendësprokurori i Përgjithshëm;
9. Drejtori i Radiotelevizionit Shqiptar;
10. Kryetari i Akademisë së Shkencave;
11. Kryetari i Komunitetit Mysliman;
12. Kryetari i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane;
13. Kryetari i Konferencës Ipeshkvore;
14. Kryetari i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare;
15. Kryetarët e partive politike;
16. Asistent/ndihmës, kameraman dhe fotograf i Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit;
17. Personat që me ligj të posaçëm gëzojnë të drejtën për pajisjen me pasaportë shërbimi.
18. Funksionarët dhe nëpunësit publikë, me autorizim të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, për shkak të specifikës së funksionit apo detyrës shtetërore që kryejnë.

VENDIM
Nr. 22, datë 24.4.2019

PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORISË SË KLIENTIT PËR REZIDENCAT STUDENTORE PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 13, 14, 28 dhe 29 të ligjit nr. 8102 datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 24.4.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Miratimi i projektvendimit: "Për përcaktimin e kategorisë së klientit për rezidencat studentore publike"",

Vëren se:

1. Shoqëria "Rezidenca Studentore Universitare nr. 2" sh.a., me anë të shkresës nr. 699 prot., datë 10.8.2018, me lëndë: "Kërkesë për rishikimin e çmimit të ujit", si dhe shkresës nr. 817 prot., datë 6.11.2018 me të njëjtën lëndë ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Ujit (ERRU) kërkesën për ndryshimin e kategorisë së konsumatorit nga "Ent Privat" në "Ent Publik" në marrëdhënie me shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a..
2. Në pikën 2.9 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 "Për miratimin e modelit të rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve sh.a."" (Kodi i Ujit) përcaktohen kategoritë e konsumatorëve në sektorin ujësjellës kanalizime, ku përfshihen konsumatorët familjarë, entet publike dhe entet private.
3. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) me anë të vendimit nr. 4, datë 29.2.2012, "Për përcaktimin e kategorisë së konsumatorëve për disa klientë të veçantë", i ndryshuar me vendimin e KKRR nr. 31, datë 27.4.2018, "Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 4, datë 29.2.2012, "Për përcaktimin e kategorisë së konsumatorëve për disa klientë të veçantë"" (Vendimi i KKRR nr. 4, datë 29.2.2012, i ndryshuar) ka përcaktuar kategorinë në të cilën do të përfshihen disa

klientë të veçantë të shoqërive ujësjellës kanalizime si: ambasadat, konsullatat, rezidencat diplomatike, selite e partive politike, selitë e komuniteteve fetare, objektet e kultit dhe shoqëritë tregtare shtetërore.

4. Gjithashtu në nenin 1 të vendimit të KKRR nr. 39, datë 9.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" (vendimi i KKRR nr. 39) dhe në nenin 1 të vendimit të KKRR nr. 42, datë 9.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura" (vendimi nr. 42 i KKRR) janë përcaktuar përkufizimet e kategorive të klientëve në sektorin Ujësjellës Kanalizime, ku me "Konsumatorë publik" nënkuptohet: çdo person/subjekt ligjor të klasifikuar si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare (ambasada, konsullata dhe rezidenca diplomatike), selitë e partive politike dhe degëve te tyre si dhe çdo institucion i cili kryen aktivitet me interes të përbashkët ose publik që nuk është regjistruar si organizatë fitimprurëse, ndërsa me "Ent privat" nënkuptohet: çdo person/subjekt ligjor ose organizatë fitimprurëse që ushtron veprimtari tregtare apo industriale të çfarëdo lloji përfshirë edhe shoqëritë tregtare shtetërore (KESH sh.a., Ndërmarrjet e trajtimit të studentëve e të tjera të ngjashme).

5. Nevoja e ndryshimit të kategorisë së klientit nga "Klient privat" në "Klient publik" në marrëdhënie me shoqërinë Ujësjellës Kanalizime nga ana e Rezidencës Studentore nr. 2 Tiranë, argumentohet:

a) Shoqëria Rezidenca Studentore nr. 2, Tiranë, është një shoqëri tregtare me kapital publik e organizuar në formën e shoqërisë aksionare dhe ka si aksionar të vetëm Bashkinë Tiranë. Objekti kryesor i veprimtarisë së kësaj shoqërie publike është trajtimi i studenteve të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Mjekësisë, Infermierisë dhe Universitetit të Sporteve, Tiranë me fjetje dhe ushqim.

b) Shoqëria Rezidenca Studentore nr. 2, Tiranë, subvencionohet nga Buxheti i Shtetit për përballimin e kostove të veprimtarisë së saj por ende nuk arrihet mbulimi i plotë i tyre. Megjithatë Rezidenca Studentore nr. 2, Tiranë, shlyen në mënyrë të rregullt faturat e konsumit të ujit.

c) Shoqëria Rezidenca Studentore nr. 2, Tiranë, vlerëson ndryshimin e kategorisë së klientit nga "Klient privat" në "Klient publik", si një mënyrë që do të ndikonte në uljen e kostove, veçanërisht në kushtet kur rikonstruksioni i disa godinave të saj e ka rritur ndjeshëm përdorimin e ujit jo vetëm për pirje dhe higjienë por edhe për ngrohje, duke rritur kostot e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

6. Referuar kërkesës së Rezidencës Studentore nr. 2, Tiranë, dhe duke vlerësuar situatën e rezidencave studentore publike në vend, rezulton se:

a) Në 6 qytete në Shqipëri ushtrojnë aktivitetin rezidenca studentore publike, për akomodimin e studenteve që ndjekin studimet e larta pranë Universiteteve publike;

b) Ndonëse rezidencat studentore janë të regjistruara si shoqëri tregtare me kapital publik, marrësit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura në godinat e rezidencave studentore publike janë studentë të universiteteve publike, kategori kjo e cila duhet të mbështetet në drejtim të lehtësimit të ngarkesës së detyrimeve gjatë periudhës se ndjekjes së studimeve;

c) Pavarësisht se palët në kontratën për shërbimin ujësjellës kanalizime janë Shoqëria Ujësjellës Kanalizime dhe Shoqëria e Rezidencës Studentore, tarifën e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura e paguajnë studentët sepse ata janë përdoruesit e këtyre shërbimeve. Tarifat e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura përcaktohet nga ERRU dhe asnjë palë përveç shoqërisë se licencuar ujësjellës kanalizime nuk ka të drejtë të ofrojë këtë shërbim, pasi sipas përcaktimeve ligjore rishitja është e ndaluar;

d) Ndryshimi i kategorisë së klientit për rezidencat studentore nga klient privat në klient publik ka efekt financiar të ulët në të ardhurat e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe nuk ndikon aktivitetin e tyre;

e) Ulja e kostove të ushtrimit të aktivitetit për rezidencat studentore publike në vend do të sjellë mundësinë e përmirësimit të shërbimit ndaj

studentëve, pa cenuar aktivitetin normal të shoqërive ujësjellës kanalizime.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi se ndryshimi i kategorisë së klientit për rezidencat studentore publike në vend ndikon në uljen e kostove të funksionimit të tyre, sjell mundësinë e rritjes së cilësisë së shërbimit që do të marrin studentet e institucioneve të arsimit të lartë publik që akomodohen pranë këtyre rezidencave, nuk cenon funksionimin normal të shoqërive ujësjellës kanalizime, si dhe duke vlerësuar se ky ndryshim është në përputhje me ligjin nr. 8102 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Rezidencat Studentore Publike në të gjithë vendin klasifikohen si klientë publik në marrjen e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura nga shoqëritë ujësjellës kanalizime.

2. Në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 4, datë 29.2.2012, "Për përcaktimin e kategorisë së konsumatorëve për disa klientë të veçantë", në pikën 1/d togfjalëshi "Ndërmarrjet e Trajtimit të Studenteve", hiqet.

3. Në nenin 1 të vendimit të KKRR nr. 39, datë 9.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", në përkufizimin "Ent privat" , togfjalëshi "Ndërmarrjet e trajtimit të studentëve", hiqet.

4. Në nenin 1 të vendimit të KKRR nr. 39, datë 9.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", në fund të përkufizimit "Konsumator publik" , shtohet togfjalëshi "..si dhe Rezidencat Studentore Publike".

5. Në nenin 1 të vendimit nr. 42, datë 9.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura" në përkufizimin "Ent privat" , togfjalëshi "Ndërmarrjet e trajtimit të studentëve", hiqet.

6. Në nenin 1 të vendimit të KKRR nr. 42, datë 9.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", në fund të përkufizimit "Konsumator publik", shtohet togfjalëshi "..si dhe Rezidencat Studentore Publike".

7. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit për njoftimin e shoqërive ujësjellës kanalizime për marrjen e këtij vendimi.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha shoqëritë ujësjellës kanalizime që kanë si klientë të tyre rezidenca studentore publike.

9. Efektet financiare fillojnë në datën 1.6.2019.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

KËRKESE
Nr. 5883/1, datë 12.6.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti: "Rikonstruksioni i kompleksit të shkollave dhe terreneve sportive Fier Shegan" Lushnjë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë e paluajtshme, pronë private, e cila do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është **60 060 (gjashtëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë) lekë**.

ZËVENDËSMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

Lista emërore e pronarëve të pasurisë pronë private që shpronësohet, pasi preket nga realizimi i projektit: "Rikonstruksioni i kompleksit të shkollave dhe terreneve sportive Fier Shegan", Lushnjë

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Sipërfaqja totale	Sip.shpronësimi Tokë/arë/m²	Çmimi Tokë/arë/m²	Vlera totale/lekë	Shënime konfirmuar ose jo nga ZVPP-ja
1	Bp.Dritan Zenel Myzeqari, Besnike Zenel Topi, Naxhije Zenel Paja, Ervehe Zenel Biçakaj, Adem Zenel Myzeqari, Feride Zenel Sharka, Shaqire Zenel Murdarasi, Merjeme Zenel Hysa	1615	283/10	851	165	364	60,060	Konfirmuar nga ZVRPP
	Vlera totale e shpronësimit						**60,060**	

KËRKESË
Nr. 5884/1, datë 12.6.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Rikualifikim i breg liqenit me struktura publike rekreative, zadra/mol panoramik dhe shtigje këmbësore natyrore".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur bazuar në VKM nr. 138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar, si dhe në udhëzimin nr. 3 datë 28.12.2016, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, për vitin 2016", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 566, 610 (pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

Lista e pronarëve të pasurive pronë private që preken nga realizimi i projektit:

"Rikualifikim i breg liqenit me struktura publike rekreative, zadra / mol panoramik dhe shtigje kembesore natyrore" , Bashkia Tiranë

Nr	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	Nr. i Pasurisë	Sip. Totale Truall (m²)	Sip. Truall i prekur (m²)	Çmimi Truall lek/m²	Sip. Obj. totale (m²)	Sip. Obj. e prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë	Shënime në kartelë
1	Shtet	Truall	8280	1/308	953	953.00					0.0	Kjo pasuri është e okupuar nga Z.Haziz Brahim Sina.
2	Bashkia Tiranë	Truall	8280	1/309	701.00	94.00					0.0	
3	Shtet	Trotuar	8280	1/365	3601	65.00					0.0	
4	Shtet	Shesh	8280	1/364	17115	2138.00					0.0	
5	Shtet	Truall	8280	1/35	3204	3204.00					0.0	Kjo pasuri është e okupuar.
6	Shtet	Truall	8280	1/105	38	38.00					0.0	
7	Ilmi Sina	Ndertese	8280	1/105/ND				30	30.00	18,887.00	566,610.0	
	Total					6492	m2		30	m2	566,610	lekë

Shënim:

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.
2. Llogaritjet paraprake janë bazuar në shkresën e ZVRPP, Tiranë, nr. prot. 31360/1, datë 23.08.2017, nr. prot. 38517/1, datë 20.11.2018 dhe nr. prot. 38517/4, datë 24.12.2018.
3. Për ndërtesat, vlerësimi është bërë sipas VKM nr.138, dt.23.03.2000 (i ndryshuar) dhe sipas çmimeve të EKB, për qytetin e Tiranës, të miratuara me udhëzimin nr 3, datë 28.12.2016 të Këshillit të Ministrave, vënë në dispozicion me shkresën nr. prot. 684, datë 27.03.2018.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë